

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Një dimër i vështirë na pret", bota drejt krizës, Mitsotakis kërkon ndërhyrje evropiane për çmimet e karb uranteve
ADRESA	https://newsbomb.al/rajon/nje-dimer-i-veshtire-na-pret-bota-drejt-krizes-mitsotakis-kerkon-nderhyrje-i401519
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 09:31:49 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 09:23:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	fcceffa038cd6e0647b0b0918058def9ad21c7ee760d1e8f5b1a75c8051dfe29
TEKSTI	9dba6cb34e4f6c06e55393b0194b4eada406227b26332acd4c6609f871706125
PAMJA	6ee662ce3c754832092af5e03a132a3dbb061e92ecfbba19d3eb9f691323cb64

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	fa19c98136c5ea8fbbf84bb73df6fcac515dc7e9b50778c86cd3f03cebe83304
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	219f872b2d436154cbce21b1357d2a6f04cc2d43ba2a7914d91c1ebdf0665477
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/fa19c98136c5ea8fbbf84bb73df6fcac515dc7e9b50778c86cd3f03cebe83304

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

[Kreu](#) [Politikë](#) [Aktualitet](#) [Ekonomi](#) [Kulturë & Art](#) [Rajon](#) [Sport](#) [Bota](#) [Showbiz](#) [SocialBomb](#)

Çështjet kryesore

Haga vendos për katër ish-krerët e UÇK-së!

Arrestohet Ergys Agasi

"Retreat"-i i qeverisë në Pogradec!

Rajoni

18 Shtator 2026, 11:23

"Një dimër i vështirë na pret", bota drejt krizës, Mitsotakis kërkon ndërhyrje evropiane për çmimet e karburanteve



Shkruar nga Newsbomb



Kyriakos Mitsotakis

E gjithë bota është në ankth për muajt që do të vijnë pas, kjo dhe për shkak të luftës në Lindjen e Mesme dhe destabilitetit ekonomik që ka sjellë me vete. Së fundmi, kryeministri i Greqisë, Kyriakos Mitsotakis ka pranuar dhe një "dimër i vështirë" e pret vendin.

"Një dimër i vështirë na pret në një mjedis trazirash gjeopolitike të paprecedentë", deklaroi kryeministri grek, duke e vendosur çështjen e koston së ngrohjes në qendër të diskutimeve.

Mitsotakis theksoi se nafta për ngrohje përbën një nga prioritetet kryesore të qeverisë, veçanërisht për familjet në Greqinë e Veriut, ku temperaturat më të ulëta e bëjnë këtë shpenzim edhe më të rëndësishëm gjatë muajve të dimrit.

"Do të ketë një ndërhyrje të dyfishtë, me një subvencion në pompë dhe një rritje horizontale të pagesës për ngrohje", u shpreh kryeministri, duke shtuar se mbështetja për naftën do të vijojë.

Sipas tij, masat synojnë të frenojnë ndikimin e rritjes së çmimeve mbi familjet greke në një periudhë kur tensionet gjeopolitike dhe pasiguritë në tregjet ndërkombëtare po ushtrjnë presion mbi kostot e energjisë.

Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



Aktualitet

Përfshihet nga flakët "Mercedesi" në një parkim nëntokësor në Fier, tymi i dendur mbulon zonën



Aktualitet

Komandant Mala dhe ushtarët e UÇK-së japin MESAZH nga Porti i Durrësit: Na u dënuan çilirimtarët, duam të kthejmë buzëqeshjen dhe në Shqipëri (VIDEO)

Zbulu më shumë artikuj >

Mitsotakis: Çështjen e taksës së karburanteve do ta ngre në Evropë

Krahas masave të brendshme, kryeministri grek kërkoi edhe një përgjigje të përbashkët në nivel evropian. Mitsotakis tha se do ta ngrejë urgjentisht në Këshillin Evropian çështjen e Taksës së Posaçme të Konsumit mbi karburantet, duke argumentuar se Greqia nuk ka hapësirën e nevojshme fiskale për të ndërmarrë në mënyrë të njëanshme një ulje të taksimit pa prekur shpenzime të tjera.

Sipas tij, një ulje e përkohshme e barrës fiskale mbi karburantet do të ishte e mundur përmes një marrëveshjeje të përbashkët evropiane për përjashtimin e përkohshëm të lëndëve djegëse fosile nga një pjesë e taksimit.

"Evropa duhet të qëndrojë pranë qytetarëve të saj", theksoi Mitsotakis, duke kërkuar që përballimi i krizës energjetike të mos mbetet vetëm përgjegjësi e qeverive kombëtare.

Një pjesë tjetër e deklaratave të kryeministrit iu kushtua situatës në tregjet ndërkombëtare të obligacioneve dhe financave publike. Mitsotakis theksoi se Greqia është në një pozicion më të mbrojtur përballë presioneve të tregjeve, duke iu referuar nivelit të huamarrjes së vendit dhe përmirësimit të financave publike.

Ai vuri në dukje se Greqia merr hua në nivele më të ulëta krahasuar me disa prej ekonomive të mëdha evropiane dhe me Shtetet e Bashkuara, duke e lidhur këtë me disiplinën fiskale të ndjekur nga vendi.

Megjithatë, presionet e jashtme mbeten një shqetësim për ekonominë greke. Rritja e kostove të energjisë, pasiguria gjeopolitike dhe luhatjet në tregjet ndërkombëtare mund të ndikojnë drejtpërdrejt në familjet dhe bizneset.

Për këtë arsye, qeveria greke po përgatit masa për të kufizuar ndikimin e rritjes së çmimeve gjatë muajve të dimrit, ndërsa Athina kërkon që një pjesë e përgjigjes ndaj krizës të koordinohet në nivel evropian. Në qendër të kësaj përpjekjeje mbetet kostoja e ngrohjes, ndërsa muajt e ardhshëm pritet të tregojnë se sa i fortë do të jetë presioni që zhvillimet gjeopolitike dhe tregjet e energjisë do të ushtrojnë mbi ekonominë greke.

Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu



🕒 E Premte 10:26

"Pa maska, me fytyrat tona", veteranët e UÇK-së protestojnë në Prishtinë pas vendimit të Hagës





Rajoni

Ç'mund të ndodhë me shtatë figurat e UÇK-së që u përmendën në aktgjykimin e 16 shtatorit?

E Premte 09:51



Rajoni

"Është krenar që ka luftuar për Kosovën e re", avokatja e Jakup Krasniqit: Asnjë dëshmitar nuk tha se ishte keqtrajtuar nga ai, përkundrazi, folën me shumë vlerësim (E PLOTË)

E Enjte 23:27



E Enjte 22:13

81 vite për Çlirimtarët, ish-emisari amerikan: Kosova nuk ka nevojë për një gjykatë në Holandë që të marrë vendime, sepse dënimi ishte i ndikuar politikisht



Rajoni

Haga e bëri fajtor, Hashim Thaçi i drejtohet popullit dhe sfidon Gjykatën: Të bëhen publike provat për vrasjen e Heroit të Kosovës, Behajdin Allaqi

E Enjte 21:39



Rajoni

U dënua me 25 vite burg nga Dhomat e Specializuara, reagon për herë të parë Hashim Thaçi! Thirrje qytetarëve të Kosovës: Ruani qetësinë

E Enjte 18:53



E Enjte 18:26

Dimri po afron, Mitsotakis njofton ndërhyrjen në tregun e hidrokarbureve: Nafta do të shitet 1.75 euro/litri për...



Rajoni

Pasi Haga dha 81 vite burg për ish-krerët e UÇK-së, Kurti pret Hamzan, diskutohet APELIMI i aktgjykimit

E Enjte 17:45



Rajoni

FOTO-LAJM/ Vendimi i Hagës nuk e lë pa shpresë familjen e Rexhep Selimit, bashkëshortja e tij krahë fëmijëve: Gjithmonë krenarë e të fortë

E Enjte 15:46



Rajoni



E Enjte 13:07 Newsbomb

"O Hashim ti ku je? Krejt Kosovën këtu e ke!" Studentët nuk heqin dorë, mbushin dhe sot Prishtinën, "në këmbë" për çlirimtarët (PAMJE-DETAJE)



Rajoni

Ministri i Arsimit italian merr zarf kërcënues me një plumb brenda, reagon Meloni: Akte frikacake nuk kanë vend në një demokraci

E Enjte 12:15



Rajoni

E TURPSHME/ "Kalbu në burg o i mjerë", politikani malazez nuk përmbahet ndaj Hashim Thaçit pas vendimit të Hagës

E Enjte 10:38



Rajoni



🕒 E Enjte 10:11

“Prita 6 vjet që babai im të vinte, por ma kthyen me eshtrat e copëtuara”, rrëfimi

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.